

**L I G J**  
**Nr.8245, datë 24.9.1997**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7806, DATË 17.3.1994 "PËR DISA NDRYSHIME  
NË LIGJIN NR.7574, DATË 24.6.1992 "PËR ORGANIZIMIN E DREJTËSISË DHE DISA  
NDRYSHIME NË KODET E PROCEDURAVE PENALE E CIVILE"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Neni 1 i ligjit nr.7806, datë 17.3.1994 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7574, datë 24.6.1992 "Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile"" ndryshohet si më poshtë:

"Gjykatat e apelit funksionojnë në zona të caktuara nga Presidenti i Republikës me propozimin e ministrit të Drejtësisë. Ato përbëhen nga kryetari, zëvendëskryetari dhe gjyqtarët.

Kompetencat dhe mënyrat e gjykimit përcaktohen në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile, si dhe në ligje të veçanta".

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.1943, datë 26.9.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**